



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300377/3

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë.*

**Drejtuar:** Z. Ulsi MANJA  
Ministër i Drejtësisë

**TIRANË**

Znj. Albana KOÇIU  
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

**TIRANË**

Z. Admir ABRIJA  
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

**TIRANË**

**Për dijeni:** Znj. Nertila KOKA  
Drejtoreshë e I.E.V.P Lezhë

**LEZHË**

*Të nderuar,*

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të shtetasve, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), zhvilloi një vizitë inspektuese në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë.

Vizita inspektuese u zhvillua në datë 28.04.2023 dhe kishte si tematikë vlerësimin e kushteve në IEVP Lezhë për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve rekreative për të burgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre. Në përbërje të grupit inspektues ishin Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca, Komisioneri i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e

Torturës, z. Ahmet Prençi, dhe nd/komisionerë znj Nertila Qafzezi, z. Besnik Deda, znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Lindita Dedgjoni pranë Mekanizmit Kombëtar.

Një aspekt tjetër i vizitës inspektuese, kishte të bënte me monitorimin e situatës së trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor të transferuar në këtë institucion, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, Marrëveshjen e Bashkëpunimit “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore” ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) të nënshkruar më datë 23.11.2021, si dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë për këtë qëllim.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën ligjore t’ju parashtojë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

### **Shënime të përgjithshme**

Në vite, Avokati i Popullit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mbikëqyrjes të situatës së respektimit të të drejtave dhe lirive të personave që vuajnë nga sëmundje dhe çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, të cilët kanë qëndruar në IEVP “Zahari”, si dhe në IVSHB (Spitali i Burgjeve), Tiranë, apo dhe në sektorët e kujdesit të veçantë pranë institucioneve të ekzekutimit të dënimeve penale, ashtu si edhe në spitale/pavione psikiatrike me shtretër.

Vlen të theksojmë që në krye të herës se, në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuara dhe të ratifikuara nga legjislativi shqiptar, përcaktohet qartë se, shtetasit për të cilët është dhënë masa mjekësore “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i përkohshëm”,  **nuk** duhet të jenë të akomoduar në IEVP në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, por ata duhet të trajtohen në një Institucion të Posaçëm Mjekësor në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ligji nr.44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, ka përcaktuar qartë se, trajtimi shëndetësor për personat me çrregullime të shëndetit mendor, pavarësisht veprës penale që kanë kryer dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur masën “mjekim i detyruar” apo “shtrim i detyruar”, duhet të kryhet në një Institucion të Posaçëm Mjekësor, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar, dhe jo në institucionet e sistemit penitenciar.

Konkretisht, në nenin 28, pika 2 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.*

Ky përcaktim ligjor, tregon qartë prioritetin që ligji i ka dhënë mbrojtjes së shëndetit të këtyre personave, pavarësisht natyrës së veprës penale që ata kanë kryer, si dhe ka përcaktuar qartësisht institucionin mjekësor të posaçëm dhe varësinë institucionale, ku duhet të kryhet trajtimi mjekësor i tyre.

Edhe Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës (KPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në vitin 2018, në raportin me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare, ka theksuar se: *“Administrimi i spitalit të ri në burgun e Lezhës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mundësojë shërbime të specializuara për këtë kategori, duke bërë të mundur aksesin e këtyre pacientëve në aktivitete kuptimplota jashtë qelive, përkujdesjen e nevojshme njerëzore dhe kontaktin me specialistë (psikiatër, psikologë, kujdestarë)”*.<sup>1</sup>

Pavarësisht presionit të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendase, si dhe disa përpjekjeve nga ana e qeverive ndër vite, për të ndërtuar një institucion të veçantë për personat me masë mjekësore me vendim gjykatë, ende edhe sot nuk është arritur asnjë rezultat konkret, përfshirë këtu edhe mos miratimin e VKM-së në zbatim të nenit 28/2 të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”.

Bazuar në Rezolutën e Kuvendit datë 09.07.2020, *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2019”*, Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2020, i kërkoi Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), si dhe të raportojë në kohë pranë Kuvendit të Shqipërisë për nevojën e adresimit të problematikave të përsëritura ose për të cilat kërkon angazhim nga ana e tij.

Duke mbajtur në konsideratë masat që institucionet përgjegjëse ishin angazhuar të ndërmarrin gjatë hartimit të përgjigjes së Qeverisë Shqiptare, datë 27 Shkurt 2020, mbi raportin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës së tyre në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018<sup>2</sup>, kemi kërkuar nga institucionet përgjegjëse të na informonin sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, mbi rekomandimet të cilat më pas janë renditur jo sipas rëndësisë por sipas radhës së gjetjeve në këtë raport. Duke mbajtur në konsideratë në rekomandimet për masat që duhet të ndërmerren nga organet kompetente për zbatimin e tyre, Avokati i Popullit ka adresuar edhe përgjigjen e dhënë nga qeveria Shqiptare në lidhje me rekomandimet e KPT-së dhe ka vlerësuar si mision të tij edhe monitorimin e zbatimit apo efektshmërisë të masave të marra sipas kësaj përgjigje<sup>2</sup>, e cila përbën një fakt pozitiv për adresimin e çështjeve të ngritura në këtë raport.

Metodologjia e hartimit të këtij raporti<sup>3</sup> konsistoi në studimin e Raportit të KPT-së dhe në vijim zbatimin e tij si pjesë të metodologjisë sonë të inspektimit në observim, në dokumentim, në komunikimet me shkresa dhe emalin zyrtar, si dhe në takimet me zyrtarët e lartë të sistemit të burgjeve, Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe sistemit

<sup>1</sup> CPT Report 2019, faqet 7,37,38, si dhe faqja 45, <https://rm.coe.int/16809cb571>

<sup>2</sup> Përgjigjja e qeverisë Shqiptare është dërguar në datë 27 Shkurt 2020.

<sup>3</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORTI%20I%20CPT%20AVOKATI%20I%20P%20POPULLIT.pdf>

shëndetësor, si dhe në inspektimet e vazhdueshme pranë institucioneve të sistemit të burgjeve, si dhe atyre shëndetësore.

Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka nisur shkresat përkatëse me lëndë: *“Kërkesë për informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues”*, drejtuar Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë (për dijeni Ministrisë së Brendshme) dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve (për dijeni Ministrit të Drejtësisë).

Për sa më lart dhe në vijim të kërkesave të mësipërme, bëjmë me dije se pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet e mësipërme dhe mbi bazën e gjetjeve faktike, kemi hartuar këtë raport të ndarë sipas seksioneve me gjetjet të ndara:

*“a. Rekomandimet e KPT-së”<sup>4</sup>;*

*“b. Përgjigjja zyrtare”<sup>5</sup>;*

*“c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës”;*

*“d. Komentet e MKPT-së”.*

Pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet e mësipërme dhe mbi bazën e gjetjeve faktike, kemi hartuar një *Raport të Veçantë* mbi zbatimin dhe problematikat e tyre sipas gjetjeve të vetë MKPT-së gjatë monitorimeve të njëpasnjëshme, raport i cili u publikua në datën 14.07.2022.

Raporti i KPT-së është i një rëndësie të veçantë për shtetet të cilat kanë ratifikuar *“Konventën Evropiane kundër Torturës dhe Dënimeve, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese”*. KPT kryen vizita në vendet ku privohet liria, në mënyrë që të monitorojë se si trajtohen personat të cilëve iu është privuar liria, në institucionet si: burgje, qendrat e paraburgimit për të miturit, komisaritet e policisë, qendrat e mbajtjes së migrantëve, spitalet psikiatrike, shtëpitë e kujdesit social, etj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) seksion i Avokatit të Popullit, që nga momenti i bërjes publike të raportit të KPT-së (Shtator 2019), në inspektimet periodike të kryera pranë këtyre institucioneve ka monitoruar në vijimësi hapat e ndjekura nga institucionet për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së, si dhe ka kërkuar nga këto institucione informacion sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, mbi rekomandimet të cilat i kemi renditur në këtë raport.

Nga ana jonë u hartua raporti *“Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradues”*. Ky raport përmbledh gjetjet dhe konkluzionet më të rëndësishme në qasjen e institucioneve shqiptare, të cilat me anë të politikave të tyre duhet të respektojnë të drejtat e personave të privuar nga liria.

---

<sup>4</sup> shih: <https://rm.coe.int/168097986b>. *“Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2019).*

<sup>5</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571>. *“Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).*

Raporti i Avokatit të Popullit “*Monitorimi i institucioneve në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor dhe Degradies*” (CPT) u bë publik në Korrik të vitit 2022 dhe iu dërgua menjëherë për njohje Presidentit, Kryeministrit, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Burgje dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

Informacioni i marrë tregoi se nga shumica e institucioneve të monitoruara, janë ndërmarrë disa hapa lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KPT-së për të mbrojtur të drejtat e personave të privuar liria. Megjithatë rezulton se institucioneve shqiptare iu duhet ende punë për të kuptuar dhe përjetësuar këto rekomandime, duke i bërë ato pjesë të pandashme të filozofisë së tyre të punës. Kjo gjë mungon, pasi kuptohet edhe nga përgjigjet që ne kemi marrë nga institucionet përkatëse se nuk kemi zbatim thelbësor të tyre, por zbatimi është krejtësisht formal. Per sa më sipër, Avokati i Popullit thekson se duhet promovuar dhe mbajtur lart zbatimi i këtyre standardeve që rrjedhin nga rekomandimet e KPT-së.

Avokati i Popullit, nëpërmjet monitorimit të këtij Raporti ka risjellë në vëmendjen e institucioneve, rëndësinë thelbësore të këtyre gjetjeve dhe rekomandimeve të dala nga ky monitorim për institucionet shtetërore, lidhur me parandalimin e keqtrajtimin në vendet e privimit të lirisë në fokusin e respektimit të të drejtave të njeriut.

**Ndër problematikat thelbësore të trajtuara në këtë raport mund të veçojmë: kushtet në burgje, situata e pacientëve me masë mjekësore, të dënuarit me probleme të shëndetit mendor, mungesa e stafit mjekësor, mungesa e medikamenteve, mjetet mjekësore të amortizuara ose në mungesë, aktivitetet jashtë qelisë, kontakti me botën e jashtme, trajnimi fillestar i stafit etj.**

Në përfundim të këtij Raporti, Avokati i Popullit ka dalë me disa rekomandime të përgjithshme për të gjitha institucionet të përfshira në këtë proces, ku ndër të tjera theksojmë:

- ❖ Nevojën për koordinim më të mirë nga institucionet eprorë në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së nga institucionet përkatëse sipas përgjegjësisë;
- ❖ Mungesën e kuptimit thelbësor të Raportit nga organet zbatuese që rezulton në mos angazhimin maksimal në dhënien e rëndësisë së duhur zbatimit të këtyre rekomandimeve;
- ❖ Nevojën emergjente për trajnimin e punonjësve të cilët janë të angazhuar në zbatimin e këtyre rekomandimeve; Zbërthimin në detyra specifike të këtyre rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse dhe marrjen e masave konkrete për zbatimin e tyre;
- ❖ Hartimin e një plani masash për zbatimin e tij në vijimësi dhe ngritjen e një mekanizmi përgjegjës dhe efikas për ndjekjen e zbatimit të këtyre rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse dhe kontrollin e tyre të herëpashershëm nga institucioni epror;
- ❖ Marrjen e masave për zbatimin efektiv dhe real të rekomandimeve të KPT-së, pasi vetëm dërgimi i shkresave për njohjen dhe zbatimin e këtij raporti nuk ka arritur qëllimin për realizimin e tyre;

- ❖ Njohjen e menjëhershme të drejtuesve të emëruar rishtazi në institucionet zbatuese me këtë raport, pasi ndryshimet e shumta në struktura kanë sjellë për pasojë standarde të ndryshme në realizimin e tyre.

Rekomandimet e KPT-së janë një garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe për rrjedhojë duhet të bëhen pjesë integrale e punës së përditshme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre; Implikimet buxhetore në shumicën e rasteve kanë sjellë një ritëm të ulët ose dhe pamundësinë në zbatimin e rekomandimeve dhe për pasojë kanë sjellë kushte dhe trajtim çnjerëzor në respektimin e të drejtave të njeriut;

Institucionet në të shumtën e rasteve kanë reaguar mbi zbatimin e rekomandimeve pas kërkesave të përsëritura nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit pa i kushtuar vëmendjen e duhur dhe rëndësisë së këtij raporti;

Monitorimet në vijimësi të institucionit të Avokatit të Popullit sjellin në mënyrë të vazhdueshme në vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse rëndësinë e marrjes së masave dhe zbatimit të rekomandimeve të KPT-së, zbatimi i të cilave mbetet në masë të ulët; Niveli i zbatimit të rekomandimeve të KPT-së është i ulët duke mbajtur në konsideratë se ka kaluar një kohë e mjaftueshme nga zbardhja e këtij Raporti, dhe se masat e marra deri më tani nuk kanë sjellë rezultatet e kërkuara;

Moszbatimi i përpiktë i rekomandimeve të KPT-së sjell për pasojë mosrespektimin/shkeljen e standardeve të kërkuara dhe gjithëpranuara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

Ky raport përmbledh gjetjet dhe konkluzionet më të rëndësishme në qasjen e institucioneve shqiptare, të cilat me anë të politikave të tyre duhet të respektojnë të drejtat e personave të privuar nga liria.

**Avokati i Popullit vlerëson se ky është një proces i cili ka nevojë thelbësore që standardet e vendosura të ruhen dhe kushtet të përmirësohen në vijimësi.**

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 28.04.2023 në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë, informacionit të grumbulluar me drejtuesin dhe stafin e institucionit, informacionit dhe evidentimit në vend të kushteve ku mbahen dhe trajtohen shtetasit me masë mjekësore, si dhe intervistave konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi se:<sup>6</sup>

#### **Ishte zbatuar rekomandimi:**

- Ishin marrë masat **pjesërisht** për shtimin e personelit shëndetësor me mjek të përgjithshëm, mjek psikiatër, mjek kardiolog, mjek laborant klinik biokimik, infermierë, sanitarë dhe kujdestarë për pacientë me masë mjekësore, si më poshtë vijon: sektori shëndetësor në seksionin e masave shëndetësore nga 18 personel shëndetësor aktual, të bëhet me 36 mjekë dhe infermierë Sanitarë për pacientët me masë mjekësore nga 5 punonjës, të bëhet me 10 sanitarë; kujdestarë për pacientët me masë mjekësore nga 5 punonjës, të bëhet me 10 kujdestarë.

---

<sup>6</sup>. Të dërguar rekomandimi nr. K4/18-7 datë 24.6.2022.

Ndërkohë, nga inspektimi rezultoi se **nuk kishin gjetur zbatim rekomandimet e mëposhtme:**

- Nuk ishin marrë masat nga Ministria e Shëndetësisë për gjetjen e hapësirave për hartimin e akteve nënligjore dhe administrative për kalimin e personave të braktisur nga familjarët që qëndrojnë në IEVP Lezhë në godinat 4 dhe 5 të cilat duhet të kalojnë në kujdesin e strukturave dhe qendrave të kujdesit social shtetëror.
- Nuk ishin marrë masat për reduktimin e mbipopullimit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P), Shënkoll, Lezhë.
- Nuk ishin marrë masat e nevojshme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, në Planin e Veprimit të përbashkët për trajtimin e personave me masë mjekësore, për detajimin e aktiviteteve specifike me afate kohore konkrete, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
- Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e godinave nr.4 dhe nr.5 me të gjithë infrastrukturën dhe bazën e nevojshme mjekësore për trajtimin e personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar”.

**Gjatë inspektimit, u konstatua se gjendja aktuale e godinave 4 dhe 5 të parashikuara për spital paraqitej si më poshtë vijon:**

**Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit** IEVP Lezhë në datë 28 shkurt 2023, Avokati i Popullit konstatoi se në seksionin e personave me masë mjekësore **ishin akomoduar në total 418 persona**, nga të cilët **233** shtetas me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, **181** shtetas me masë mjekësore “shtrim i përkohshëm”, si dhe **4** shtetas paraplegjik të dënuar me vendim gjykate nën përkujdesje mjekësore.

Ndërkohë, sipas projektit të ndërtimit për përshtatjen në spital të ambienteve në dy godinat e IEVP Lezhë, pajisja me shtretër ishte për mbajtjen dhe trajtimin e **184 (maksimumi 200) shtetasve** me masë “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”, përveç ambienteve të destinuara si sallë për urgjencat, laboratorët, klinikat mjekësore të mjekëve, dhomat e infermierëve, për personelin mbështetës (sanitar dhe kujdestarë), si dhe ambienteve për punën e administratës.

Akomodimi i këtyre personave me masë mjekësore në IEVP, trajtimi dhe akomodimi jo adekuat i personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” të vendosur nga gjykata, mbi kapacitetin fizik në IEVP Lezhë, është denoncuar vazhdimisht nga institucioni i Avokati i Popullit, si një shkelje flagrante e ligjit dhe e standardeve ndërkombëtare, që sjell trajtim diskriminues dhe denigrues të këtyre pacientëve si dhe përkeqësim të gjendjes së tyre shëndetësore.

Personat me çrregullime të shëndetit mendor e kanë domosdoshmëri trajtimin nga mjeku specialist psikiatër dhe nga ekipi multidisiplinar, në çdo kohë, pavarësisht nga regjimi i mbajtjes së tyre.<sup>7</sup>

---

<sup>7</sup> CPT/Inf(92)3 – part 2, parag. 56.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, shtetasve me masë mjekësore iu janë cënuar rëndë të drejtat e tyre, kjo pasi prania e tyre në burgje është e kundërligjshme. Kësaj i shtohet edhe fakti që në vite nuk ka patur një përmirësim të qenësishëm në rritjen e numrit të stafit mjekësor, **si dhe situata e braktisjes terapeutike e konstatuar edhe përgjatë inspeksionit, ende nuk ka ndryshuar. Kjo problematikë mbipopullimi në I EVP Lezhë ka përkeqësuar klimën në këtë institucion.**

Referuar rekomandimeve të përsëritura të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare si Komitetit kundër Torturës të Këshillit të Evropës KPT) organizatave jofitimprurëse që operojnë në vend (Komiteti Shqiptar i Helsinkit KSHH, Shoqata Përthyerje, etj.), paraprakisht u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në datë 23.11.2021 “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore”.

Në lidhje me situatën dhe problematikën në të cilën ndodheshin personat e akomoduar në I EVP Zahari, Avokati i Popullit ka dërguar në muajin nëntor të vitit 2021 një rekomandim drejtuar autoriteteve shtetërore përgjegjëse të ngarkuara me ligj, ku ndër të tjera ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me kapacitetet akomoduese të strukturës së re në I EVP Lezhë, si dhe ka përsëritur nevojën për kompletimin me staf shëndetësor shtesë që do të duhet të kishte struktura e re, sipas standardeve dhe protokolleve shëndetësore për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor<sup>8</sup>.

Organika në I EVP Lezhë paraqitet si më poshtë, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit, Nr.9855/1 Prot, Datë 19.10.2022, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, me qëllim shtrirjen e strukturës organike në I EVP-të.

### **Punonjës civil 95 persona ndër të cilët:**

- Sektori ligjor me 7 punonjës.
- Sektori i çështjeve shoqërore me 11 punonjës ndër të cilët 1 përgjegjës sektori dhe 5 punonjës specialist psikolog dhe 5 punonjës social.
- Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve 38 punonjës nga të cilët 10 janë kujdestarë (për pacientët me masë mjekësore) dhe 10 sanitarë.
- Staf i për sektorin e policisë përbëhet nga 201 punonjës sigurie.

### **Stafi për seksionin e masave Mjekësore I EVP Lezhë.**

Shef shërbimi (Mjek i Përgjithshëm/ Mjek Specialist)-1 Mjek.

Mjek i Përgjithshëm /Mjek Specialist – 1 Mjek.

Mjek Psikiatër – 4 Mjek (2 Mjekë Psikiatër me kohë të plotë 1 Mjek Psikiatër part time dhe një mungesë).

Mjek Kardiolog- 1 Mjek.

Mjek Laborant Biokimik – 1 Mjek.

Mjek Stomatolog – 1 Mjek.

---

<sup>8</sup> Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministria e Drejtësisë me shkresë nr.6667/1 prot., datë 17.01.2022 drejtuar Avokatit të Popullit, ka shprehur dakortësinë për çështjet e ngritura nga AP dhe thekson se: “Pomerrren masa në bashkëpunim me MSHMS, në përputhje me detyrimet e marrëveshjes së bashkëpunimit rregjistruar pranë MD me nr.6111 prot., datë 23.11.2021 dhe regjistruar pranë MSHMS me nr.4787 prot., datë 23.11.2021 “Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore”.



Kryeinfermier – 1 punonjës.  
Infermier - 10 Punonjës.  
Infermier /Laborant – 1 punonjës.

**Përgjatë inspektimit konstatuam se mungesat në stafin e organikës ishin në total 10 punonjës dhe paraqiteshin si më poshtë:**

1-Specialist /Jurist.  
1-Përgjegjës i burimeve njerëzore dhe shërbimeve.  
1-Kuzhinier.  
1-Mjek specialist.  
1-Mjek Psikiatër.  
1-Mjek Kardiolog.  
1-Mjek Laborant Biokimik.  
2-Infermier.  
1-Infermier Laborant.

Në vizitën inspektuese në IEVP Lezhë u evidentua se situata ishte mjaft problematike. Qartazi në konstatimin tonë struktura aktuale shëndetësore, por dhe stafi ndihmës (sanitarë dhe kujdestarë) e IEVP Lezhë e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit, Nr.9855/1 Prot, Datë 19.10.2022, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, me qëllim shtrirjen e strukturës organike në IEVP-të, nuk i përmbushte pritshmëritë për një trajtim sa më dinjitoz të këtyre personave.

**Avokati i Popullit thekson faktin se nisur nga mbipopullimi i theksuar dhe për shkak të numrit në rritje të personave me masë mjekësore të cilët vendosen në I.E.V.P. Lezhe, struktura e sipërcituar nuk i përmbush kërkesat për ofrimin e këtij shërbimi ndaj personave me çrregullime të shëndetit mendor duke përfshirë edhe mungesat në staf. Kapacitetet akomoduese janë shumë të vogla e të pamjaftueshme në përbërje për të përballuar numrin e personave të akomoduar në këtë IEVP si dhe personat e transferuar rishtazi në këtë institucion, por edhe për trajtimin e tyre në bazë të protokollit shëndetësor.**

Nga vizita inspektuese e datës 28 shkurt 2023, u konstatua se, në të dy godinat ishin akomoduar në total **418 persona me masë mjekësore**, nga 184 persona që është kapaciteti fizik i tyre, **në kushtet e një shtate mbipopullimi me 234 persona mbi kapacitetin e numrit të përgjithshëm për mbajtjen dhe trajtimin mjekësor të tyre.** Në secilën nga dhomat ndodheshin gati 2 herë më shumë persona sesa kapaciteti, duke i bërë kushtet të papërshtatshme për trajtimin dhe rehabilitimin e tyre. Pavarësisht mbipopullimit, personat e akomoduar ishin të pajisur të gjithë me krevat dhe asnjëri prej tyre nuk flinte me dyshekë në tokë.

Duke qenë se, situata e mbipopullimit në këtë institucion është e evidente, për arsye të menaxhimit të kushteve në të cilat ndodhen, drejtuesit e IEVP Lezhë ishin detyruar të shtonin numrin e shtretërve dhe personave në dhoma nga 2 në 4 deri dhe 7 në 10 persona, madje duke përshtatur në dhoma banimi edhe ambientet të cilat ishin të parashikuara për punën e stafit të administratës dhe stafin ndihmës dhe mbështetës.

Evident ishte gjithashtu dhe fakti se në të dy godinat 4 dhe 5 ku akomodohen personat me masë mjekësore, mungonin ambientet për trajtimin e tyre si këshillim terapeutik, konsulta në

grup e punë kreative. Në këto ambiente kishte vetëm dy salla të pajisura me televizor një nga të cilat nga sektori social ishte planifikuar që të përdorej në grup. Gjithashtu ambientet për ajrimin e personave me masë mjekësore ishin në ambientin e hapur para godinave, që në ditët me shi dhe kohë të keqe e kishin të pamundur të dilnin, pasi këto ambiente ishin të pambluara me strehë mbrojtëse.

Sikurse e referuam edhe më lart, ndër vite kjo kategori personash ka vuajtur dhe jetuar në kushte jo dinjitoze dhe në kundërshtim me aktet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe shteti shqiptar është ndëshkuar për këtë problematikë. Konkretisht, në datë 21 janar 2020, Shqipëria humbi gjyqin në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut, në rastin “*Strazimiri kundër Shqipërisë*”<sup>9</sup>. GJEDNj konstatoi në veçanti që kishte pasur një dështim të gjatë nga autoritetet shqiptare **për të ngritur një institucion të posaçëm mjekësor për të sëmurët mendorë**, të cilët ishin privuar nga liria në rastet e trajtimit të detyrueshëm mjekësor të urdhëruar nga gjykata vendase. Në të gjitha raportet, që janë hartuar apo rekomandimet që janë adresuar në këtë fushë, është evidentuar fakti se sa i rëndësishëm është krijimi i një Institucioni të Posaçëm Mjekësor në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin shqiptar, me qëllim trajtimin mjekësor dhe psikiatrik që e ka të domosdoshëm kjo kategori e personave me masë mjekësore. Ofrimi i një infrastrukture me kushte të tilla, do të japë mundësinë e një jete me dinjitet e në respekt të të drejtave të njeriut. Në Rregullat Europiane të burgut<sup>10</sup> miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës më 12 shkurt 1987<sup>11</sup> vendosen parimet e përbashkëta të politikës penale midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Komiteti i Ministrave rekomandon qeveritë e shteteve anëtare që në legjislacionin dhe praktikën e tyre të brendshme në fushën e burgjeve, të udhëhiqen nga parimet e “Rregullave Europiane të Burgut”. Megjithëse këto rregulla nuk kanë karakter detyrues ligjor në të drejtën ndërkombëtare, ato përbëjnë një kod të standardeve dhe të praktikës që bazohen në konsensusin e përgjithshëm të të gjithë atyre vendeve që i kanë miratuar rregullat nga pikëpamja politike ose në planin ligjor.

Në këtë aspekt, *mbyllja e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në institucione të veçanta brenda sistemit penitenciar*, përbën dhunim të rëndë të të drejtave të tyre, pasi në një farë mënyre i vendos ata në një formë të përjetshme të privimit të lirisë<sup>12</sup>, kjo pasi, gjendja e papërgjegjshmërisë mendore tek të sëmurët mendorë kronikë mund të zgjasë gjatë gjithë jetës së tyre, dhe si rrjedhim, edhe izolimi në institucione të veçanta do të ishte i përjetshëm.

Siç e evidentuam dhe më lart, Avokati i Popullit e vlerëson si një hap pozitiv Planin e Përbashkët të Veprimit dhe është i rëndësishëm fakti që IEVP Lezhë konsiderohet “institucion tranzitor”, deri në konkretizimin e hapave për ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor.

Konkretisht në përmbajtjen e marrëveshjes së bashkëpunimit përcaktohet se:

---

<sup>9</sup> Ky rast kishte të bënte me ndalimin e një njeriu, i cili ishte përjashtuar nga përgjegjësia penale për shkak të sëmundjes mendore, në një burg në vend të një institucioni mjekësor. Parashtruesi ankohej në veçanti se kushtet e ndalimit të tij, përfshirë sigurimin e kujdesit mjekësor, ishin joadekuate. Ai po ashtu konsideronte se ishte vendosur në një burg edhe pse gjykatat kishin urdhëruar mbylljen e tij në një institucion mjekësor, se nuk i ishte dhënë mundësia që ligjshmëria e ndalimit të tij të vendosej shpejt nga një gjykatë dhe se ligji i brendshëm nuk i kishte ofruar një të drejtë të zbatueshme për kompensim.

<sup>10</sup> Referuar Rekomandimit 2006 (2) i Këshillit të Ministrave për shtetet anëtare për Rregullat Europiane të Burgjeve, miratuar nga Këshilli i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të Zëvendësministrave. Ky dokument është shpërndarë në të gjitha burgjet shqiptare më datën 13.04.2012.

<sup>11</sup> Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës që nga viti 1995.

<sup>12</sup> Albrecht, H.J. Plenary speech – Punimet e Konferencës së dytë vjetore të Max Planck Partner Group on Balkan Criminology, ‘Imprisonment in the Balkans’, 17-19 shtator 2015, Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë.

*Ministria e Drejtësisë merr përsipër:*

- a) Vendosjen në dispozicion të pajisjeve që disponon, me qëllim përshtatjen dhe pajisjen me aparaturat e nevojshme të dy godinave pranë Institucionit të Kujdesit Shëndetësor, Lezhë duke siguruar mjedis fizik të përshtatshëm për ofrimin e kujdesit terapeutik, human dhe të sigurtë për personat me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore, sipas përcaktimeve të nenit 28 të ligjit nr 44/2012 “Për shëndetin mendor”.
- b) Ofrimin e masave të sigurisë për ruajtjen e këtij institucioni.
- c) Vazhdimin dhe përmirësimin e kujdesit të sigurtë nëpërmjet rishikimit të protokolleve dhe procedurave për funksionimin e këtij institucioni transitor dhe trajnimeve të stafit.

*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale merr përsipër:*

- a) Ofrimin e shërbimit të specializuar psikiatrik mbështetës për stafin e institucionit të Kujdesit Shëndetësor Lezhë nëpërmjet angazhimit të mjekëve sipas nevojave.
- b) Sigurimin e diagnostikimit dhe trajtimit të specializuar.
- c) Ofrimin e ekzaminimeve laboratorike, depistime epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë nëpërmjet ISHP-së.
- d) Planifikimin e ngritjes dhe funksionimit të Institucionit Mjekësor të posaçëm, si strukturë e posaçme për ofrimin e një kujdesi terapeutik.

Por, referuar planit të veprimit të përbashkët, pavarësisht se parashikohet kryerja e vlerësimeve për çdo pacient, rezulton se, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka arritur në një qasje pozitive dhe aktive pasi përgjatë inspektimit konstatohet qartazi braktisja terapeutike e personave mjekësore në IEVP Lezhë, kjo në proporcion me numrin e lartë të pacientëve që trajtohen në I.E.V.P. Lezhë.

Në Strategjinë Kombëtare të Shëndetësisë 2021-2030, MSHMS ka përcaktuar masa konkrete për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor për të cilët gjykata kompetente ka dhënë masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i detyruar”. Gjithashtu përcaktohet se duhet urdhëruar ngritja e institucionit mjekësor të posaçëm për trajtimin e personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, me kapacitet rreth 350 shtretër funksionalë.

Në këto kushte, kur në IEVP Lezhë është evidente situata e mbipopullimit, kërkohet që autoritetet përgjegjëse shtetërore si Ministria e Drejtësisë, MSHMS dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të kryejnë menjëherë një studim bazuar në numrin e personave që janë me masë mjekësore në sistemin e burgjeve, **për nevojën e rritjes së numrit të stafit mjekësor, si dhe shtimin e kapaciteteve fizike të këtij institucioni, me qëllim mbajtjen dhe trajtimin e këtyre personave, sipas protokolleve shëndetësore.**

Sikurse parashikohet dhe në ligjin nr.44/2012 “Për shëndetin mendor”, menaxhimi i këtij spitali duhet të kalonte tërësisht nën administrimin dhe kujdesin e MSHMS, për të ofruar ndihmën dhe trajtimin e specializuar përkatës. Kjo masë e marrë aktualisht, mbetet shumë larg plotësisht të këtij detyrimi ligjor.

Një problematikë tjetër, që u ngrit nga stafi social gjatë inspektimit ishte braktisja e personave me vendim gjykate, kurim ambulator, nga familjarët e tyre dhe për pasojë rikthimi i tyre në institucion si persona me masë mjekësore.

Për shkak të kontingjentit të akomoduar në institucion, ku aktualisht lista emërore e shtetasve me masë mjekësore të braktisur nga familjarët është 127 persona, Sektori i Çështjeve Shoqërore ka punuar në drejtim të bashkëpunimit me OJF-të e shoqata të ndryshme për t'i ardhur në ndihmë këtyre shtetasve. Vlen të theksohet se Kisha Katolike luan një rol bazë në sigurimin e veshmbathjeve në sasi të mëdha për të gjithë kategorinë e akomoduar në institucion.

### ***Trajtimi***

Grupi i inspektimit, kishte për qëllim mbledhjen e informacionit lidhur me garantimin e të drejtave dhe trajtimin e personave me masë mjekësore që trajtohen në këtë institucion, identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie, mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave, procedurat që ndiqen nga komisioni për pritjen e tyre në institucion, aktivitetet e zhvilluara, trajtimin shëndetësor, cilësia e ushqimit, furnizimi sipas normativave me detergjente dhe mjete të higjienës personale, etj.

Referuar komunikimit me stafin e I.E.V.P. Lezhë u informuam se në momentin e hyrjes së shtetasit me masë mjekësore në dhomën e këshillimeve ai pajiset me formatin e kërkuar nga ana e stafit, të cilin e plotëson e në rastet kur është i paqartë mbi objektin e kërkuar, shtetasi udhëzohet mbi plotësimin e saj. Kjo kërkesë hidhet pranë postës së Institucionit e cila ndodhet në korridorin e Regjimit të Brendshëm në të dy godinat. Kjo postë menaxhohet nga Sektori i Çështjeve Shoqërore dhe hapet çdo ditë në orën 13:00. Kërkesat regjistrohen më parë nga përgjegjësi dhe më pas dërgohen pranë sekretarisë së Institucionit. Të gjitha kërkesë-ankesat përcillen për njohje dhe ciklim nga ana e titullarit të institucionit dhe më pas i kalohen për veprim përgjegjësve të sektorëve me afate të përcaktuara, në bazë edhe të natyrës së kërkesës.

Komunikimin me telefon me familjet e tyre personat me masë mjekësore e zhvillonin normalisht me telefonat me kartë të vendosur në mjediset e korridoreve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe keta persona kryenin 8 telefonata në muaj me familjet dhe të afërmit e tyre.

### **Kushtet Materiale**

Grupi i monitorimit, inspektoi plotësimin e kushteve në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, sipas kërkesave ligjore dhe në respektim të standardeve më të mira për jetesë dhe aktivitete të personave me masë mjekësore të akomoduar në godinën kryesore në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së, në Shënkoll, Lezhë.

**Gjatë inspektimit, u konstatua se gjendja aktuale e godinave 4 dhe 5 të parashikuara për spital paraqitej si më poshtë vijon:**

Ne godinat 4 dhe 5 të banuar me shtetas me mase mjekësore rezultojnë te akomoduar **418 shtetas**, te sistemuar ne 59 dhoma gjithsej, konkretisht:

**-Godina nr.4**, kishte kapacitet për shtrimin dhe trajtimin gjithsej të 97 pacientëve me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Aktualisht, godina nr. 4 ishte 3 kate

**-Godina nr. 4 kati i pare** ka gjithsej 10 dhoma banimi prej te cilave 8 janë te populluara me 60 paciente të shtuar dhe (1 dhome observim dhe 1 dhome tjetër si dhoma e kufizimit fizik.)

**-Godina nr. 4 kati i dyte** ka gjithsej 12 dhoma banimi te populluar me 79 paciente.

**-Godina nr. 4 kati i trete** ka gjithsej 12 dhoma banimi te populluara me 75 paciente.

**-Godina nr.5** kishte kapacitet për shtrimin dhe trajtimin me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, për 87 pacientë.

**-Godina nr. 5 kati i pare** ka gjithsej 3 dhoma banimi te populluara me 29 paciente.

**-Godina nr. 5 kati i dyte** ka gjithsej 12 dhoma banimi te populluar me 78 paciente.

**-Godina nr. 5 kati i trete** ka gjithsej 12 dhoma banimi te populluar me 75 paciente.

Tre shtetas me mase mjekësore ndodhen te akomoduar ne ambientet e infermierisë.

Gjithashtu ne ambientet e infermierisë ndodhen te akomoduar dhe 4 te dënuar me statusin paraplegjik.

Gjithashtu, në të dy godinat kapaciteti maksimal ishte 184 persona. Në ditën e inspektimit, në mjediset e institucionit ishin 418 persona, pra me një mbipopullim prej 234 ose 227 % personash mbi kapacitet.

Dhomat e kufizimit fizik në të dy godinat mungonin, dhomat të cilat përdorshin nga institucioni si ambiente kufizimi nuk ishin të pajisura me krevat fiksues dhe mjetet shtrënguese, të parashikuara me ligjin nr. 44/2012, dt. 01.06.2012. “Për Shëndetin Mendor”.

Dhomat e banimit ishin të pajisura brenda me tualete, të cilat në përgjithësi ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare por kanë nevojë në çdo kohë për lyerje dhe dezinfektim. Ambienti i dusheve për larjen e trupit ishte i përbashkët dhe ndodhej në fundin e korridorit të çdo sektori, ku secili sektor kishte nga 4 dushe të cilët ndodheshin në çdo kat për çdo sektor por konstatuam se disa prej tyre nuk ishin funksionale.

Kuzhina ishte në katin e parë të hapësirës së ndërmjetme të godinës. Ambienti brenda ishte i pastër dhe kishte kushte të mira higjieno-sanitare, por kishte nevojë për lyerje, si dhe për vënien në funksion të aspiratorit, pasi sistemi i aspirimit kishte dalë jashtë funksionit rreth një vit më parë. Gjithashtu, kishte të nivel të lartë të lagështirës, i cili ishte problem shqetësues në ambientet e gatimit. Në kuzhinë punonin katër kuzhinierë dhe një punonjës mirëmbajtjeje. Menyja e përditshme ishte e afishuar. Gjithashtu, kampionet e ushqimit ishin të etiketuar dhe mbaheshin me çelës në ruajtje në frigorifer, për çdo vakt ushqimi. Për personat diabetikë ishte hartuar një meny e veçantë. Përgjithësisht, nga intervistat e kryera nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit, por ata ngritën si shqetësim larmishmërinë dhe normën e ushqimit, e cila nuk u përgjigjej nevojave të tyre. Mungesa e

larmishmërisë vjen si rezultat i normave të ulëta të ushqimit ditor, të përcaktuara në urdhërin e përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Lavanderia ndodhej në ambient më vete në I.E.V.P. Shënkoll, Lezhë, ishte funksionale dhe e pajisur me 2 lavatriçe. Kjo lavanderi ishte për godinën 4 dhe 5 si dhe për godinën nr.1. Por nga inspektimi konstatuam se ajo ishte e pamjaftueshme për personat me masë mjekësore të cilët më së shumti kanë nevojë për këtë shërbim.

### **Aktivitetet e personave me masë mjekësore**

Salla në godinën nr.5, për efikasitetin dhe realizimin e mirëfilltë të programeve individuale trajtuese është përshtatur për realizimin e terapisë së artit ku angazhohen rreth 5 shtetas me masë mjekësore dhe një shtetas i dënuar, në një hark kohor rreth 3 orë gjatë orarit të veprimit në regjimin e brendshëm të Sektorit të Çështjeve Shoqërore (09<sup>00</sup>-13<sup>00</sup>).

Pas bashkëbisedimeve dhe marrëveshjes së arritur me Drejtorinë e Formimit Profesional Publik Shkodër pritet brenda muajit mars fillimi i kurseve profesionale për shtetasit me masë mjekësore, kryesisht në kursin e berberit dhe në kursin e hoteleri – turizmit. Për realizimin dhe zhvillimin e këtyre kurseve është përshtatur njëri krah i sallës në godinën nr.5. Gjithashtu në ambientet e godinës organizohen aktivitete festive duke organizuar bankete, lojëra argëtuese dhe aktivitete sportive.

Spektori i çështjeve shoqërore ka punuar në drejtim të bashkëpunimit me OJF-të e shoqata të ndryshme për t'iu ardhur në ndihmë personave që janë braktisur nga familjarët ose vijnë nga familje me nivel shumë të ulët social- ekonomik.

Funksionimi i veprimtarive ditore dhe programeve të tjera rehabilituese, si dhe angazhimi i plotë i shtetasve me masë mjekësore kryhet pjesërisht, kjo për shkak dhe të numrit të madh të personave të akomoduar. Në kuadër të ruajtjes së higjienës, sektori i çështjeve shoqërore punon edhe në motivimin dhe edukimin e mënyrës së ruajtjes së higjienës vetjake dhe jo vetëm, si pjesë e programit terapeutik okupacional.

Pavarësisht situatës, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se, procesi i edukimit nuk duhet të ndërpritet, pasi ka një rëndësi të veçantë në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave. Ky proces, duhet të përfshijë programet e trajtimit individual, por dhe punën në grupe, duke marrë në konsideratë nevojat individuale psikologjike, shoqërore, moshën, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar, veprën penale si dhe faktorët e riskut. Ka nevojë të shtohet kapaciteti njerëzor dhe burimet financiare për të mundësuar zhvillimin e këtyre aktiviteteve për të dyja godinat.

### **Shërbimi shëndetësor**

Organika e sektorit shëndetësor përbëhej nga 21 punonjës prej të cilëve:

Shef shërbimi (Mjek i Përgjithshëm/ Mjek Specialist)-1 Mjek;

Mjek i Përgjithshëm /Mjek Specialist – 1 Mjek;

Mjek Psikiatër – 4 Mjek (2 Mjekë Psikiatër me kohë të plotë 1 Mjek Psikiatër part time dhe një mungesë);

Mjek Kardiolog- 1 Mjek;

Mjek Laborant Biokimik – 1 Mjek;  
Mjek Stomatolog – 1 Mjek;  
Kryeinfermier – 1 punonjës;  
Infermier - 10 Punonjës;  
Infermier /Laborant – 1 punonjës.

Shërbimi shëndetësor ndodhej në katin e parë të godinës në regjimin e brendshëm. Në një ambient të veçantë ndodhej dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia dhe dhoma për konsultat ditore dhe rastet e urgjencës. Dhomat e vizitave ishin të plotësuara me krevate dhe shtroje, në kushte të mira higjieno-sanitare. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Grupi i inspektimit, konstatoi se institucioni ishte furnizuar rregullisht me ilaçe si për rastet urgjente, ashtu edhe për mjekimin e të sëmurëve kronikë. Furnizimi me ilaçe bëhej sipas skemës së rimbursimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe me ilaçe të siguruara nga fondi i veçantë në dispozicion të Institucionit. Nga këqyrja e dokumentacionit rezultoi se, si regjistri për vizitat e kryera nga stafi mjekësor i institucionit ashtu dhe regjistri i të sëmurëve kronikë për konsultat jashtë institucionit, ishte i plotë. Gjithashtu, në dhomën e mjekut ndodhej edhe “Libri për ekzaminimin e rasteve të keqtrajtimit dhe të dhunës”. Të gjithë formatet e kontrollit mjekësor ishin të mbajtura me rregull. Regjistrat e informacionit 24 orësh të infermierëve, ishin plotësuar sipas rubrikave. Kartelat mjekësore ishin të plotësuara në mënyrë korrekte dhe mbaheshin të mbyllura me çelës.

Gjithashtu për sa parashtruar më lart, ritheksojmë se është e nevojshme dyfishimi i personelit shëndetësor dhe ndihmues, në funksion të mirëadministrimit dhe plotësimit të nevojave shëndetësore të pacientëve.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;

### **REKOMANDOJMË:**

1. Deri në ngritjen e Institucionit të Posaçëm Mjekësor, **të merren masa të menjëhershme**, për hartimin/miratimin e rregullores së funksionimit të Institucionit Tranzitor Lezhë.
2. Të merren masa të menjëhershme nisur nga situata e mbipopullimit në I.E.V.P. Lezhë për të shtuar kapacitetet e shërbimit mjekësor dhe shërbimeve mbështetëse të këtij institucioni, me qëllim rritjen e cilësisë të shërbimeve ndaj personave me masë mjekësore, të cilët në situatën aktuale gjenden para një braktisje terapeutike.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e vakancave në stafin mjekësor:

1-Mjek specialist;  
1-Mjek Psikiatër;  
1-Mjek Kardiolog;  
1-Mjek Laborant Biokimik;  
2-Infermier;  
1-Infermier Laborant.

Si dhe në sektorët e shërbimit:

1-Specialist /Jurist;  
1-Përgjegjës i burimeve njerëzore dhe shërbimeve;  
1-Kuzhinier.

4. Marrjen e masave për vënien në zbatim të Planit të Përbashkët të Veprimit për trajtimin e personave me masë mjekësore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, për trajtimin e personave me masë mjekësore, me aktivitete specifike dhe me afate kohore konkrete për këta persona, sipas angazhimeve të marra në marrëveshjen e përbashkët, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.44/2012 “Për shëndetin mendor” dhe ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.
5. Marrjen e masave nga Ministria e Shëndetësisë për gjetjen e hapësirave për hartimin e akteve nënligjore dhe administrative për kalimin e personave të braktisur nga familjarët që qëndrojnë në I EVP Lezhë nga godinat 4 dhe 5 në kujdesin e strukturave dhe qendrave të kujdesit social shtetëror.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për uljen e mbipopullimit i cili është numër i dyfishuar referuar kapacitetit akomodues në këtë institucion, duke cenuar rëndë të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë.
7. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e godinave nr.4 dhe nr.5 me të gjithë infrastrukturën dhe bazën e nevojshme mjekësore për trajtimin e personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar”.
8. Marrjen e masave për riparimin e posteve të dusheve të cilat ishin jofunksionale.
9. Marrjen e masave për pajisjen e lavanterisë me lavatriçe shtesë në mënyrë që të jetë në proporcion me numrin e lartë të personave të akomoduar.
10. Marrjen e masave për trajnimin fillestar të stafit të punësuar rishtazi në I EVP Lezhë kjo nisur dhe nga protokollin i veçantë që duhet të zbatohet sektori social për këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë.



11. Marrjen e masave për sigurimin e ambienteve për trajtimin e tyre si këshillim terapeutik, konsulta në grup dhe punë kreative.
12. Marrjen e masave për pajisjen e ambienteve për ajrimin me streha mbrojtëse për të mundësuar procesin e ajrimit edhe në kushte atmosferike jo të përshtatshme.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**ERINDA BALLANCA**